



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI SHKENCA SHOQËRORE

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

HISTORI

GJEOGRAFI

SOCIOLOGJI

PSIKOLOGJI




Prishtinë, qershor 2015

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

HISTORI

1. Si zgjedheshin zyrtarët e pushtetit ekzekutiv në Republikën e Romës?
 - A. Nga Kuvendet popullore
 - B. Nga dinastia mbretërore
 - C. Me grushtet ushtarak
 - D. Me trashëgimi familjare
2. Besimi i krishterë sipas doktrinës fetare bënë pjesë në grupin e religjioneve :
 - A. Politeiste
 - B. Totemiste
 - C. Monoteiste
 - D. Animiste
3. Në Kongresin e Berlinit (1878) Serbisë ju njohë pavarësia dhe një zgjerim i madh territorial në dëm të tokave shqiptare. Cilat nga dy vendbanimet me shumicë shqiptare iu dhanë Serbisë?
 - A. Qarku i Novipazarit dhe i Shkupit
 - B. Qarku i Nishit dhe i Vrajës
 - C. Qarku i Ohrit dhe i Manastirit
 - D. Qarku i Mitrovicës dhe i Prishtinës
4. Identifikoni ngjarjen historike që lidhet me personalitetin në fjalë :
 - A. Revolucioni i Tetorit -Vlladimir Iliç Lenin
 - B. Përhapja e reformacionit – Leonardo Da Vinçi
 - C. Zbulimi i shtypshkronjës –Gjon Buzuku
 - D. Beteja e parë e Kosovës-Gjergj Kastrioti Skënderbeu
5. Cili armatim modern u përdor për herë të parë në Luftën e Parë Botërore?
 - A. Raketa
 - B. Bomba atomike
 - C. Aeroplanët e dirigjuar
 - D. Tanku
6. Në fotografinë e dhënë është paraqitur figura e patriotit dhe krijuesit letrar shqiptar:
 - A. Fan S. Noli
 - B. Gjergj Fishta
 - C. Faik Konica
 - D. Luigj Gurakuqi
7. Cila ishte njëra nga masat kryesore që ndërmori Bashkimi Sovjetik si reagim ndaj sulmit gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore?
 - A. Përdorimi në masë i armëve biologjike
 - B. Përdorimi në masë i armëve bërthamore
 - C. Zhvendosja e industrisë nga pjesa evropiane në viset lindore
 - D. Zhvendosja e industrisë nga viset lindore në pjesën evropiane



- 8.** Termi “Luftë e Ftohët” është përdorur si sinonim për të shprehur marrëdhëniet e tensionuara pas Luftës së Dytë Botërore në mes të:
- A. Paktit trepalësh dhe fuqive të boshtit
 - B. Paktit të Berlinit dhe shteteve mesdhetare
 - C. Bllokut nazist dhe fuqive të Antantës
 - D. Bllokut komunist dhe shteteve perëndimore
- 9.** Cila ishte kërkesa kryesore e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë?
- A. Kosova Republikë
 - B. Kosova e Pavarur
 - C. Bashkimi me Shqipërinë
 - D. Hyrja në Bashkësinë Evropiane
- 10.** Cilat ishin dy nga shtetet që fituan më së shumti nga vendimet e Kongresit të Vjenës (1814-15) ?
- A. Franca dhe Italia
 - B. Anglia dhe Rusia
 - C. Belgjika dhe Holanda
 - D. Spanja dhe Portugalia
- 11.** Cili nga shtetet aziatike të poshtëshënuara filloi i pari procesin e modernizimit në shekullin XIX ?
- A. Kina
 - B. Korea
 - C. Vietnami
 - D. Japonia
- 12.** Njerëzit që lëviznin nga vendi në vend, pa një vendbanim të përhershëm quheshin:
- A. Zejtarë
 - B. Nomad
 - C. Tregtarë
 - D. Bujq
- 13.** Cili ishte perandori i parë romak?
- A. Oktaviani
 - B. Cezari
 - C. Pompeu
 - D. Ciceroni
- 14.** “ Në jetën e përditshme ata besonin në shumë Zota dhe adhuronin: Thanën-perëndinë e lindjes(plleshmërisë), Tademi-hyu i dritës dhe Iria-perëndeshë e bujqësisë. Ata po ashtu besonin edhe në jetën pas vdekjes duke u lënë atyre armë, stoli dhe gjëra të tjera.”
- Në tekstin e dhënë bëhet fjalë për besimin e:
- A. Romakëve
 - B. Ilirëve
 - C. Grekëve
 - D. Thrakasve

15.Me kalimin nga rendi feudal në rendin kapitalist fillon:

- A. Koha e Neolitit
- B. Koha e Mesme
- C. Koha e Re
- D. Koha e Vjetër

16.Në fotografinë e dhënë është paraqitur figura e themeluesit të religjionit:

- A. Hebraik
- B. Krishterë
- C. Hinduist
- D. Budist



17.Sundimtari i Perandorisë Osmane, Sulejmani I (1520-1566), në botën perëndimore është i njohur si :

- A. Sulltan Pushtuesi
- B. Sulltan Ligdhënësi
- C. Sulltani i Tmerrshëm
- D. Sulltan Fatihu

18.Në cilën nga betejat e mëposhtme mori pjesë Gjergj Kastrioti Skënderbeu?

- A. Betejën e Parë të Kosovës
- B. Betejën e Maricës
- C. Betejën e Albulenës
- D. Betejën e Dytë të Kosovës

19.Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në programin e vetë politik parashihte:

- A. çlirimin e Kosovës, demokratizimin dhe mbrojtjen e shtetit shqiptarë
- B. forcimin e monarkisë së Zogut dhe Çlirimin e Çamërisë nga Serbia
- C. bashkëpunimin me Italinë dhe Organizimin e demonstratave protestuese kundër osmanëve
- D. organizimin e demonstrative në Gjermani dhe bashkëpunimin me SHBA-të

20.Cila ishte gjuha zyrtare e komunikimit në Perandorinë Romake të Perëndimit?

- A. Gjuha arabe
- B. Gjuha latine
- C. Gjuha angleze
- D. Gjuha frënge

21.Franc Ferdinandi ishte trashëgimtar i fronit perandorak të:

- A. Austro-hungarisë
- B. Gjermanisë
- C. Ruisë
- D. Francës

- 22.** Marin Barleti është një figurë e njohur e historisë shqiptare që i takon periudhës së:
- A. Iluminizmit
 - B. Skolastikës
 - C. Humanizmit
 - D. Rilindjes Kombëtare
- 23.** Nga cila fuqi koloniale e deklaroi pavarësinë shtërore Meksika?
- A. Franca
 - B. Britania e Madhe
 - C. Portugalia
 - D. Spanja
- 24.** Në gjysmën e parë të shekullit XIX në SHBA u acaruan marrëdhëniet ndërmjet Veriut dhe Jugut. Ky acarim i parapriu luftës civile në vend. Cilat ishin shkaqet shpërthimit të kësaj lufte?
- A. Vendosja e skllavërisë dhe zhvillimi i hovshëm ekonomik në pjesën jugore të vendit.
 - B. Tendanca për heqjen e skllavërisë dhe zhvillimi i pabarabartë ekonomik në mes veriut dhe jugut.
 - C. Vendosja e skllavërisë dhe zhvillimi i hovshëm politik në pjesën perëndimore të vendit
 - D. Tendanca për heqjen e së drejtës së votës për skllavërit dhe zhvillimi i hovshëm ekonomik në pjesën perëndimore të vendit
- 25.** Gjatë viteve 1839-42 shpërtheu lufta në mes të Kinës dhe Britanisë së madhe që në histori njihet si:
- A. Lufta e Opiumit
 - B. Lufta e Mëndafshit
 - C. Lufta e të Mëdhenjve
 - D. Lufta e Orientit

GJEOGRAFI

- 26.**Zonat karstike janë të pasura me:
- A. bimësi
 - B. kafshë
 - C. ujëra sipërfaqësore
 - D. ujëra nëntokësore
- 27.**Alpet Shqiptare shtrihen në tre shtete:
- A. Serbi, Maqedoni, Shqipëri
 - B. Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi
 - C. Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi
 - D. Shqipëri, Kosovë, Maqedoni
- 28.**Në cilin shtet gjendet Plava dhe Gucia?
- A. Mal të Zi
 - B. Kosovë
 - C. Maqedoni
 - D. Shqipëri
- 29.**Cilat shtete kanë dalje në det?
- A. Zvicra Qekia Serbia
 - B. Belgjika, Greqia, Rumania
 - C. Austria, Hungaria, Maqedonia
 - D. Qekia, Luksemburgu, Sllovakia
- 30.**Në cilën periudhë në orën 12 dielli qëndron më afër zenitit mbi hapësirën e Kosovës?
- A. Me 21 mars
 - B. Me 21 shtator
 - C. Me 21 qershor
 - D. Me 21 dhjetor
- 31.**Zona e tundrës shtrihen në brezin:
- A. e nxehtë
 - B. mesatarë
 - C. subtropikal
 - D. e ftohët
- 32.**Cilat nga malet bëjnë pjesë në Evropën Perëndimore?
- A. Karpatet
 - B. Apeninet
 - C. Dinarike
 - D. Rodopet
- 33.**Cili liqe është akullnajor?
- A. Lurës
 - B. Butrintit
 - C. Patokut
 - D. Ohrit

34. Cilat nga pohimet është e saktë?

- A. Peja është në veri të Prishtinës, lindje të Podujevës dhe Jugë të Ferizajt
- B. Ferizajt është në veri të Prishtinës, lindje të Podujevës dhe Jugë të Peja
- C. Prishtina është në veri të Ferizajt, jug të Podujevës dhe lindje të Pejës
- D. Podujevës është në veri të Prishtinës, lindje të Ferizajt dhe Jugë të Peja

35. Në sipërfaqen e tokës temperatura është 15°C . Bazuar në gradientin termik vertikal prej $0,6^{\circ}\text{C}$ në çdo 100m lartësi, sa do të jetë temperatura në lartësinë 3000 m?

- A. -20°C
- B. 15°C
- C. 0°C
- D. -3°C

36. Nga harta e kontinentit të Evropës konstato se kryeqytet i cilit shtet është Parisi?

- A. II
- B. I
- C. III
- D. IV

37. Shtimi natyror i popullsisë paraqet raportin:


- A. Natalitet-Emigrim
- B. Imigrim-Mortalitet
- C. Natalitet-Mortalitet
- D. Emigrim-Imigrim

38. Në cilën lartësi mbidetare gjendet numri më i madh i popullsisë botërore?

- A. 0-500 metra
- B. 500-1000 metra
- C. 1000-1500 metra
- D. 1500-2000 metra

39. Cili atraksion turistikë bënë pjesë në trashëgimin kulturore?

- A. Liqeni i Ohrit
- B. Bjeshkët e Nemuna
- C. Qyteti i Gjirokastrës
- D. Parku Kombëtar i Dajtit



40. Materiali i depozituar nga veprimi i erës quhet?


- A. Depozitim fluvial
- B. Depozitim eolik
- C. Depozitim glacial
- D. Depozitim lagunor

41. Në cilat lloje të hartave paraqiten tipet e tokave?

- A. Hartat hidrologjike
- B. Hartat fitogjeografike
- C. Hartat zoogjeografike
- D. Hartat pedologjike


42. Në një dite pa erë, temperatura e ajrit jashtë shtëpisë është 10°C , ndërsa brenda shtëpisë është 18°C . Cila nga figurat paraqet në mënyrë të qartë modelin e qarkullimit të ajrit, nëse dritarja e shtëpisë është e hapur?

- A. 3
- B. 2
- C. 1
- D. 4




43. Në figurën e dhënë është paraqitur ndryshimi i lëvizjes së ajrit gjatë ditës dhe natës, midis tokës dhe detit, kjo dukuri ndodh sepse:

- A. dielli ngroh me shumë ajrin mbi oqeanë sesa atë mbi tokë
- B. toka ngrohet dhe ftohet me shpejtë sesa uji
- C. ajri i ftohtë tenton të ngjitet lart mbi ajrin e ngrohtë
- D. uji është gjatë gjithë vitit më i ftohtë se toka



44. Në hartën 1:150000 gjatësia prej 12 km është:

- A. 10 cm
- B. 12 cm
- C. 15 cm
- D. 18 cm



45. Lartësia mesë pikave AO paraqet:

- A. lartësinë relative mbidetare
- B. lartësinë absolute mbidetare
- C. lartësinë e troposferës
- D. lartësinë e stratosferës

SOCIOLOGJI

46.Sistemet klasore dallohen prej formave tjera të stratifikimit, për shkak se janë:

- A. më të hapura me mobilitet më të theksuar
- B. më të mbyllura pa mundësi mobiliteti
- C. më hermetike por me mundësi të mëdha mobiliteti
- D. më hermetike por me mundësi të vogla mobiliteti

47.Marksisti është angazhuar për:

- A. ndryshime të ngadalshme në shoqëri
- B. ndryshime radikale në shoqëri
- C. ruajtjen e status quo-së në shoqëri
- D. ruajtjen e rendit kapitalist

48.Pushteti karizmatik sipas Veberit karakterizohet:

- A. me zgjedhjen e udhëheqësit me procedurë demokratike
- B. me qeverisje të qëndrueshme dhe të gjatë kohore
- C. me veçori hyjnore dhe aftësi magjike të personalitetit udhëheqës
- D. me pushtet të legjitimuar përmes votës së lirë

49.Monoteizmi është besim:

- A. në natyrë
- B. në Totem
- C. në shumë zotë
- D. në një Zot

50.Në kulturë kiçi është:

- A. kopjim dhe imitim
- B. kreacion dhe origjinalitet
- C. imitim dhe vlerë elite
- D. kopjim dhe origjinalitet

51.Shteti i përcakton normat:

- A. Morale
- B. Ligjore
- C. Populliste
- D. Tradicionale

52.Kastat janë:

- A. pabarazi shoqërore e rregulluar me ligj dhe fe
- B. pabarazi shoqërore e parregulluar me ligj dhe fe
- C. barazi shoqërore e parregulluar me ligj dhe fe
- D. barazi shoqërore e rregulluar me ligj dhe fe

53.Pjesët përbërëse të moralit janë:

- A. iluzionet morale, pasionet morale dhe vizionet morale
- B. emocionet morale, pasionet morale dhe motivet morale
- C. normat morale, gjykimet morale dhe sanksionet morale
- D. iluzionet morale, emocionet morale dhe vegimet morale

54.Ideologjia është:

- A. grumbull i fakteve të sakta
- B. sistem i ideve
- C. shprehje e vërtetësisë ideore
- D. realitet shkencor

55.Dallimet kryesore të racave në aspektin biologjik manifestohen në:

- A. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe konstruksionin fizik
- B. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe ideologjinë
- C. ngjyrën e lëkurës, religjionin dhe konstruksionin fizik
- D. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe gjininë

56.Tërësia e normave, vlerave dhe mënyrave të sjelljes që bën të dallojnë një grup njerëzish nga anëtarët tjerë të shoqërisë, quhet:

- A. makrokulturë
- B. subkulturë
- C. kontrakulturë
- D. teknokulturë

57.Racizmi përkufizohet si:

- A. sistem i besimit paragjykes për të tjerët
- B. mendim i gabuar për të tjerët
- C. besim se një grup ose kategori raciale është në thelb superior ndaj të tjerëve
- D. pretendim për t'i anatemuar të tjerët për fajet e tyre

58.Realizimi i drejtpërdrejtë i qëndrimit të popullit përmes votimit të lirë, quhet:

- A. demokraci plebishitare
- B. demokraci totalitare
- C. demokraci autoritare
- D. demokraci parlamentare

59.Pjesë e rëndësishme e demokracisë liberale janë:

- A. institucionet autoritare
- B. institucionet parlamentare
- C. institucionet të centralizuara
- D. institucionet autokratike

60.Mikrosociologjia studion:

- A. grupet më të mëdha, institucionet dhe formacionet shoqërore
- B. faktorët politikë dhe ekonomikë
- C. interaksionin ndërnjerëzor, marrëdhëniet ndërmjet grupeve të vogla shoqërore
- D. sistemet e ndryshme socio-ekonomike dhe politike

61.Nocionin *Zoon Politikon* (kafshë politike) e përdori:

- A. Platoni
- B. Sokrati
- C. Aristofani
- D. Aristoteli

62.Sociologjia si shkencë ka lindur gjatë:

- A. kohës së mirëqenies shoqërore
- B. luftërave Ballkanike
- C. kohës së krizave shoqërore
- D. luftës së Dytë Botërore

63.Termin *Sociologji* për herë të parë e përdori:

- A. Ogyst Konti
- B. Sen Simoni
- C. Emile Durkeimi
- D. Maks Veberi

64.Sipas Kontit, struktura shoqërore studiohet nga :

- A. Dinamika sociale
- B. Statika sociale
- C. Mobiliteti social
- D. Ndryshimi social

65.*Solidariteti organik* sipas Durkeimit, është karakteristikë e:

- A. shoqërive antike
- B. shoqërive neolitike
- C. shoqërive të hershme të pazhvilluara
- D. shoqërive të avancuara dhe të zhvilluara

PSIKOLOGJI

- 66.** Ndryshimet nervore të shkaktuara nga të mësuarit dhe nga përjetimet e ngjarjeve dhe të ndjenjave të njeriut njihen si:
- A. Neurone
 - B. Engrame
 - C. Rikonjicion
 - D. Retencion
- 67.** Si quhet kujtesa e përdorur për të mbajtur në mend, për rinjohje dhe riprodhim të përmbajtjeve psikike mendore dhe ndjenjore si dhe me kursimin e përsëritjeve për të mësuar ato?
- A. Kujtesa e qëllimshme
 - B. Kujtesa afatshkurtre
 - C. Kujtesa mentale
 - D. Kujtesa shqisore
- 68.** Gjykimi “nxënësit e rregullt i ndjekin rregullisht mësimet në shkollë” është:
- A. gjykim i shkëlqyeshëm
 - B. gjykim i veçantë
 - C. gjykim i posaçëm
 - D. gjykim i përgjithshëm
- 69.** Si quhet faza e zhvillimit psikosocial të Eriksonit gjatë rinisë së hershme?
- A. Intimiteti dhe izolimi
 - B. Shpirtmadhësia dhe pasiviteti
 - C. Zelli në punë dhe inferioriteti
 - D. Iniciativa dhe faji
- 70.** Teoria e cila thotë se ne ndryshojmë qëndrimet sepse jemi të motivuar të mbajmë vazhdimësinë midis mendimeve tona, njihet si:
- A. teoria sociale ndërpersonale
 - B. teoria e atribuimeve
 - C. teoria e vetëmonitorimit
 - D. teoria e disonancës kognitive
- 71.** Çka janë paragjykimet?
- A. Qëndrime negative
 - B. Qëndrime pozitive
 - C. Sjellje negative
 - D. Sjellje pozitive
- 72.** Testet që matim ato njohuri të cilat janë arritur gjatë të mësuarit në shkollë njihen si:
- A. teste psikologjike
 - B. teste pedagogjike
 - C. teste të inteligjencës
 - D. teste të personalitetit

- 73.** Si quhen degëzimet e fijeve të shkurta të cilat përbejnë neuronin?
- Neurite
 - Aksone
 - Dendrite
 - Sinapsë
- 74.** Si quhen substancat kimike të cilat mundësojnë bartjen e informacioneve nga pjesa parasinaptike e neuronit në pjesën postsinaptike?
- Neurotransmetues
 - Neurite
 - Neurodendrite
 - Neurofibrilet
- 75.** Cili sistem udhëheq funksionet e organeve të brendshme dhe lidhjen funksionale të sistemeve të tyre:
- sistemi nervor neurik
 - sistemi nervor qendror
 - sistemi nervor periferik
 - sistemi nervor autonom
- 76.** Truri dhe palca kurrizore përmbajnë:
- sistemin nervor qendror
 - sistemin libatik
 - sistemin neurotik
 - sistemin biokimik
- 77.** Cilët psikologë studiojnë ndryshimet kognitive dhe fiziologjike të njeriut gjatë ciklit jetësor?
- Psikologët Eksperimental
 - Psikologët Zhvillimorë
 - Psikologët Social
 - Psikologët Klinikë
- 78.** Nga aspekti kognitiv, kur individët arrijnë aftësinë për rezonim, duke përdorur koncepte abstrakte dhe hipotetike, atëherë ata janë në fazën:
- paraoperacionale
 - operacionale
 - operacionale formale
 - sensimotorike
- 79.** Teoria për zhvillimin kognitivë është e përpiluar nga:
- Gilligan
 - Piazhe
 - Kolbërgu
 - Frojdi
- 80.** Si quhen reagimet të cilat mësohen në bazë të lidhjes së tyre me reagimin natyror?
- Reflekse të kushtëzuara
 - Reflekse të rrënjësura
 - Reflekse të mësuara
 - Reflekse operante

